



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 8, datë 06.09.2023

PËR

**“APLIKIMIN E SHITESËS MBI PAGË PËR POZICIONET E PUNËS QË NDJEKIN
DHE ADMINISTROJNË SISTEMET INFORMATIKE NË AKEP BAZUAR NË VKM
NR. 325, DATË 31.05.2023”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 06.09.2023 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të DT, DMKI, DBMF, DSHB shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Për aplikimin e shtesës mbi pagë për pozicionet e punës që ndjekin dhe administrojnë sistemet informatike në AKEP bazuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2023;**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);

2. Pika 26, e lidhjes 3, të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”;
3. Pika 1 e nenit 8 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar (ligji 10296/2010);
4. VKM nr.750, datë 01.12.2022 “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023”;
5. Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023”.
6. Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP;
7. Memo Drejtoria Teknike nr.1762/2prot., datë 30.06.2023“*Kërkesë/Vlerësim mbi pozicionet e punës së DT që përfitojnë shtesë page sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 325, datë 31.05.2023 dhe nr. 1762/4prot, datë 25.08.2023 “Informacion shtesë në lidhje me memo nr. 1762/2prot, datë 30.06.2023”;*
8. Memo Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit nr.1762prot.,datë 30.06.2023“*Kërkesë/Vlerësim mbi pozicionet e punës së DMKI që përfitojnë shtesë page sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 325, datë 31.05.2023 dhe nr. 1762/5prot, datë 25.08.2023”Informacion shtesë në lidhje me memo nr. 1762prot, datë 30.06.2023”;*
9. Shkresë nr. 1849prot., datë 18.07.2023 drejtuar Departamentit të Administratës Publike “Për miratimin e shtesës së pagës sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023”.
10. Shkresë kthim përgjigje e Departamentit të Administratës Publike me nr. 3851/1Prot., datë 01.08.2023 (*administruar në AKEP me nr. 1849/1prot., datë 03.08.2023.*)

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, konkretisht përcaktimeve ligjore të pikës 26, të lidhjes 3, AKEP si Institucion në fushën e veprimit të këtij vendimi i lind detyrimi për aplikimin e shtesës në masën e përcaktuar për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për disa pozicione pune, të specifikuara në Vendim.
2. Për këtë qëllim bazuar në vlerësimin e realizuar nga 2 drejtoritë përkatëse të cilat administrojnë sisteme (Drejtoria Teknike dhe Drejtoria MKI), AKEP ka hartuar shkresën (nr. 1849prot., datë 18.07.2023) drejtuar Departamentit të Administratës Publike “Për miratimin e shtesës së pagës sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023”, në të cilën kërkon miratimin paraprak të shtesave respektive nga ky institucion, me qëllim zbatimin e tyre.
3. Strukturat përgjegjëse të AKEP në analizë edhe të sistemeve që menaxhohen prej tyre, kanë vlerësuar përgjegjësitë e punës dhe formimin profesional për çdo nëpunës në të cilin do të aplikohet shtesa mbi pagë, në raport me detyrimet që rrjedhin nga hyrja në fuqi e VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.
4. Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 3851/1Prot., datë 01.08.2023 (administruar në AKEP datë 03.08.2023) me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për miratimin e shtesës së pagës sipas VKM-së nr.325/2023”, komunikon se zbatimi i shtesave të përcaktuara në pikën 26, të lidhjes nr. 3, të VKM-së nr. 325/2023 bëhet rast pas rasti nga vetë institucionet, të cilët bëjnë vlerësimin nëse ndodhen në kushtet e përcaktuara në këtë pikë, pa marrë më parë miratimin e Departamentit të Administratës Publike.
5. Në vijim AKEP duke vlerësuar të drejtën legjitime për të aplikuar shtesa mbi pagë për pozicionet përgjegjëse për sistemet informatike në AKEP sipas formimit përkatës arsimor, ka hartuar projektaktin “Për aplikimin e shtesës mbi pagë për pozicionet e punës që ndjekin dhe administrojnë sistemet informatike në AKEP bazuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2023”.
6. Projektakti është hartuar në referencë të përcaktimeve ligjore pika 26, e lidhjes 3, të VKM nr.325/2023 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023” për pozicionet respektive të punës që administrojnë sisteme informatike në këto 2 Drejtori:
 - a) Drejtoria Teknike është Njësia Organizative Përgjegjëse që administron sistemet informatike në AKEP, e cila përveç infrastrukturës fizike dhe virtuale është përgjegjëse për sigurinë kibernetike si dhe Infrastrukturën kritike sipas përcaktimeve të VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të

Ministrave nr. 553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”.

- ✓ Sistemet kryesore të infrastrukturës kritike përfshijnë:
 - Sistemin CCTLD.al;
 - Portabilitetin e numrit;
 - Sistemin e Përqëndruar i Informacionit;
 - Sistemin e menaxhimit/monitorimit të frekuencave (Sistemi SPECTRA);
 - e-Aplikime (ish-Revzone).
- ✓ Sistemet kryesore të infrastrukturës fizike dhe virtuale përfshijnë:
 - Server fizik me Platformat e Virtualizimit;
 - Server Backup;
 - Disaster Recovery Site (DRS);
 - Pajisjet kompjuterike dhe ndihmëse;
 - Network/WiFi.
- ✓ Sistemet kryesore të sigurisë kibernetike përfshijnë:
 - Firewall;
 - SIEM;
 - SMA;
 - Antivirus.
- ✓ Sisteme të tjera informatike:
 - Access Control
 - Sistemi i menaxhimit të alerteve në dhomën e serverave (sensorët)
 - Sistemi i kamerave
 - Domain Controller
 - Active Directory
 - Shërbimi e-Mail (shërbim cloud – Office365)
 - Azure
 - Serverat Virtualë të Financës etj.

b) Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit është Njësia Organizative Përgjegjëse që administron sistemin teknik konkretisht Sistemin Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave në AKEP për verifikimin e përdorimit të frekuencave me autorizimin përkatës, zbatimit të kushteve Autorizimeve Individuale të lëshuara si dhe identifikimin e burimeve të dëmshme të interferencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, në përputhje me rekomandimet e ITU, i cili përmban stacionet monitoruese si:

- 1 Qendër Kontrolli Kryesore (MCC) – Tiranë,
- 2 Stacione fiks monitorimi (RFMS) – Pinet, Krujë,
- 5 Stacione të thjeshtë monitorues të komanduar në distance (SRFMS) – Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Fier,
- 2 Stacione të lëvizshëm monitorimit (MMS),
- 1 Stacion monitorues i transportueshëm (TMS) si edhe;
- Qendrën Kombëtare e Lëvizshme e Monitorimit të Cilësisë së Shërbimit (QoS) si dhe sistem serverash për mbledhjen, administrim, përpunimin e të dhënave në kontrollin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në përdorimin e teknologjive 2G, 3G, 4G dhe së shpejti dhe për teknologjinë 5G.

Konkretisht, sistemi "*Spectrum Monitoring System -Scorpio TCI*" dhe "*Rohde & Schwarz ARGUS*" janë dy sisteme të rëndësishme për monitorimin e spektrit të frekuencave në Republikën e Shqipërisë. Këto sisteme ndihmojnë DMKI (Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të SRF-së) të mbledhë dhe menaxhojë informacionin e nevojshëm për të siguruar përdorimin efikas të spektrit të frekuencave dhe për të koordinuar frekuencat në territorin e vendit.

Administrimi i databazës qendrore të sistemeve të monitorimit të frekuencave si dhe operimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit (software) të monitorimit të spektrit të frekuencave janë infrastruktura të cilat menaxhohen vetëm nga DMKI, kjo për shkak të specifikës së të dhënave që ato ruajnë dhe përpunojnë në kohë reale, për të cilat kërkohet informacion.

7. Për këtë qëllim bazuar në përcaktimet e mësipërme ligjore i cili kushtëzon fitimin e kësaj të drejte përmes plotësimit të dy kushteve bazë, DT dhe DMKI morën në shqyrtim pozicionet e punës respektive që plotësojnë fushën e përgjegjësisë sipas përshkrimit të punës apo detyrave funksionale, duke parashtruar të detajuara sistemet informatike që ndjekin dhe administrojnë rast pas rasti.
8. Sektorët që administrojnë sistemet e sipërcituara dhe aplikohet kjo shtesë janë:
 - a) **Sektori i Numeracionit, Sigurisë së Rrjeteve, Infrastrukturës dhe IT (DT)** i cili është sektori bazë i Drejtorisë Teknike, pasi menaxhon pjesën më të madhe të sistemeve informatike të institucionit të përshkruara në pikën 6/a të këtij Vendimi. Pozicionet e punës brenda këtij sektori që përmbushin kushtet sipas detyrave funksionale që ushtrojnë janë:

Përgjegjës i sektorit të numeracionit, sigurisë së rrjeteve, infrastrukturës dhe IT, i cili kujdeset për monitorimin dhe menaxhimin e rrjetit fizik dhe virtual, infrastrukturës fizike dhe virtuale, infrastrukturës DRS, CCTLD.al, Portabiliteti i numrit, ATLAS, e-Aplikime, Sistemit Antivirus dhe SIEM me qëllim garantimin e sigurisë së rrjetit të AKEP, kontrollet në të gjitha sistemet informatike, koordinimi i stafit për të përcaktuar objektivat dhe prioritetet teknike.

Specialist i çështjeve të faciliteteve shoqëruese dhe infrastrukturës i cili kujdeset për monitorimin dhe menaxhimin e infrastrukturës fizike dhe virtuale, kontrollet në të gjitha gjithë serverat e AKEP, Disaster Recovery Site dhe menaxhimi i SPI - ATLAS.

Specialist IT dhe shërbimeve broadband, i cili kujdeset për menaxhimin dhe monitorimin e të gjithë rrjetit të internetit në AKEP, pajisjet e shpërndarjes, pajisjet kompjuterike dhe ndihmëse, dhoma e serverave, menaxhimi i sistemeve të ndryshme informatike etj.

- b) **Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të SRF-së (DT)**, i cili nëpërmjet sistemit SPECTRA dhe SpaceCom administron databasën e frekuencave, të cilat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore, siç dhe përcaktohet në ligjin nr. 9918, i ndryshuar.

Meqënëse sistemi për administrimin e frekuencave(SPECTRA) është specifik për llojin e të dhënave që ai ruan, duhet të administrohet nga punonjës me njohuri të thelluara për frekuencat. Duke marrë parasysh këtë fakt, kjo platformë i ka kaluar nën administrim

Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit dhe Koordinimit të SRF i cili është përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave, ndërfaqes së përdoruesit, vizualizimit të të dhënave etj.

c) **Sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SRF (DMKI)** ndër detyrat kryesore të të cilit janë:

- *Mirëmbajta, administrim dhe operim i sistemeve informatike Spectrum Monitoring System – Scorpio Client , Rohde & Schwarz ARGUS.*

Funksionet kryesore të këtyre programeve janë administrimi i bazës së të dhënave të frekuencave, koordinimi dhe Inspektimi i frekuencave, analiza e interferencave, administrimi i planit kombëtar të frekuencave, koordinimi ndërkombëtar dhe inspektimi i caktimeve të frekuencave si dhe funksione të tjera që lidhen me administrimin dhe vlerësimin e brezave të frekuencave.

Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) realizojnë monitorimin dhe analizimin e të dhënave të spektrit të frekuencave në brezin 20 – 3000 MHz nëpërmjet software-it të Monitorimit ARGUS.

Spectrum Monitoring System – Scorpio kryen monitorimin periodik me anë të stacioneve fikse të monitorimit të spektrit të frekuencave RFMS dhe SRFMS me qëllim ofrimin e të dhënave të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, analizimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara, ofrimin e informacioneve të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vëndeve fqinje në eliminimin e interferencave të dëmshme.

- *Monitorimi i cilësisë (QoS)*

Ndër proceset që administrojnë Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të SRF-së pjesë e DMKI është dhe analizimi i Treguesve të Cilësisë së Shërbimit (QoS) i cili kryhet nga Specialistit i treguesve QoS.

Për analizimin e treguesve të cilësisë së shërbimit (QoS), AKEP ka në administrim Qendrën Kombëtare të Levizshme të Monitorimit të Cilësisë së Shërbimit si dhe sistem serverash për mbledhjen, administrimin, përpunimin e të dhënave në kontrollin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në përdorimin e teknologjive 2G, 3G, 4G dhe së shpejti dhe për teknologjinë 5G.

Mirëfunksionimi i sistemeve në fjalë, referuar karakteristikave strukturore të AKEP, por dhe kompetencave të sanksionuara në përkrahjen e punës, është përgjegjësi direkte e punonjësve të DMKI, Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SRF, dhe konkretisht të *Drejtorit të Drejtorisë, Përgjegjësit të Sektorit, Specialistit të Monitorimit të Cilësisë (QoS) dhe Specialistit të Sistemit të Monitorimit të SRF.*

9. Punonjësit e përzgjedhur për aplikimin e shtesës në pagë plotësojnë kriteret e përmendura në pikën 26, të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023, bazuar në diplomën universitare në degët përkatëse si dhe përshkrimin e vendit të punës.
10. Pika 26 e VKM- së nr. 325, datë 31.05.2023, përcakton se shtesa në pagë jepet përkatësisht në masën:
- 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Specialist";
 - 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Përgjegjës Sektori";
 - 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Drejtor Drejtorie" apo "Drejtor i Përgjithshëm".

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1, të nenit 114 dhe në pikën 1, të nenit 115 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë aplikimin e shtesave në pagë sipas Lidhjes nr. 1 "Lista emërore e pozicioneve të punës që ndjekin dhe administrojnë sistemet informatike në AKEP dhe aplikohen shtesat në pagë sipas VKM- së nr. 325, datë 31.05.2023".
2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Shtesa në pagë për vitin 2023 të përballohet nga fondi i shpenzimeve të AKEP, zërat "Shpenzime për paga e shtesa" si dhe "Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore", me efekte financiare duke filluar nga data 1 Prill 2023 sipas përcaktimeve të pikës 7, Kreu IV, të VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Lorenc Bako